



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Z E D H Ë N Ë S I

Tiranë, më 27/09/2014

Njoftim për Shtyp

**KLSH KALLËZON NË PROKURORI KRYETARIN E KOMUNËS GOLEM,
KAVAJË DHE ISH KRYEINSPEKTORIN E INSPEKTORATIT NDËRTIMOR
URBANISTIK VENDOR TË KOMUNËS GOLEM**

Kryerja e procedurave të parregullta të prokurimit publik dhe mos llogaritja e penaliteve për përfundimin tej afateve të punimeve të ndërtimit, shqyrtimi e miratimi i lejeve të ndërtimit duke mos respektuar kondicionet urbane, lejimi i ndërtimeve pa leje dhe mos marrja e masave për ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve, mos vendosja dhe mos arkëtimi i gjobave për ndërtimet pa leje, i kanë sjellë Buxhetit të Shtetit dhe Komunës Golem një dëm ekonomik në vlerën totale prej 57.4 milionë lekë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 305/1, datë 21.03.2014, ka audituar Komunën Golem, Kavajë, për periudhën Janar 2012-Dhjetor 2013.

Nga auditimi, u konstatuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore, mbi bazën e të cilave KLSH ka kryer kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për Kryetarin e këtij institucioni A.A. dhe ish-Kryeinspektorin e INUV Komuna Golem, Kavajë E.L. për konsumim të elementëve të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, neni 248 i Kodit Penal, pasi janë konstatuar:

Shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore lidhur me: kryerjen e procedurave të parregullta të prokurimit publik dhe mos llogaritjen e penaliteve për përfundimin tej afateve të punimeve të ndërtimit, shqyrtimin e miratimin e lejeve të ndërtimit duke mos respektuar kondicionet urbane, lejimin e ndërtimeve pa leje dhe mos marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve, si dhe mos vendosjen dhe mos arkëtimin e gjobave për ndërtimet pa leje, të cilat përbëjnë veprime të kryera në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Kreun V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, dhe nenin 34 të shtojcës 14 “Kushtet e përgjithshme të kontratës” të DST, ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, dhe VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK e INUV”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit konstatoi se A.A. me detyrë Kryetari i Komunës Golem ka kryer veprimtari në kundërshtim me ligjin për rastet e mëposhtme:

2 raste të ndërtimit të objekteve shumëkatëshe, për të cilat nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuar në lejen e ndërtimit, duke ndryshuar numrin e kateve në kundërshtim me vendimet e KRRT-së së Komunës.

Shkelje për tenderin “Ndërtimi i nënkalimit të linjës hekurudhore”, duke lejuar copëzimin e një shërbimi të vetëm të ndahet në dy tendera “Ndërtimi i mbingritjes së linjës hekurudhore tek nënkalimi hekurudhor komuna Golem” dhe “Ndërtimi i nënkalimit hekurudhor, Golem”,

veprim që sjellë rritje fiktive të vlerës së investimit me 10,919 mijë lekë, duke shkaktuar dëm me të njëjtën vlerë në buxhetin e shtetit dhe atë të njësisë vendore.

Shkelje për tenderin “Ndërtimi i mbingritjes së linjës hekurudhore tek nënkalimi hekurudhor komuna Golem” ka miratuar dhe ka bërë pagesën e vlerës prej 3,175 mijë lekë, për punime të pakryera duke shkaktuar dëm me të njëjtën vlerë në buxhetin e shtetit dhe atë të njësisë vendore.

5 raste të shkeljes së rregullave të prokurimit publik duke shpallur tendera të cilat kapin vlerën 119,892 mijë lekë ndërkohë që fondet për realizimin e investimeve nuk ishin në dispozicion të institucionit.

Shkelje për tenderin “Ndërtimi i nënkalimit hekurudhor Golem” duke miratuar shtyrjen e afateve të përfundimit të punimeve pa përlllogaritur penalitetet për 549 ditë vonesë, të cilat kanë sjellë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore në vlerën 47,583 mijë lekë.

Shkelje për tenderin “Mbingritja e linjës hekurudhore te nënkalimi hekurudhor te Komuna Golem” duke miratuar shtyrjen e afateve të përfundimit të punimeve pa përlllogaritur penalitetet për 86 ditë vonesë, të cilat kanë sjellë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të njësisë vendore në vlerën 1,854 mijë lekë.

16 raste të shkeljeve në fushën e ndërtimit për të cilat nuk janë marrë masat dhe nuk është kërkuar arkëtimi i gjobave në vlerën prej 4,800 mijë lekë, si dhe nuk janë ndjekur procedurat përkatëse penalizuese, për objektet ndërtimore dosjet e të cilave paraqisnin me parregullsi në dokumentacionin e lejeve të ndërtimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit konstatoi se E.L. me detyrë ish-Kryeinspektor i INUV Komuna Golem, Kavajë ka kryer veprimtari në kundërshtim me ligjin për rastet e mëposhtme:

27 raste të papajtushmërisë me legjislacionin në fuqi duke lejuar ndërtime për të cilat INUV nuk ka respektuar dhe përmbushur detyrimet ligjore lidhur me moslejimin e ngritjes së ndërtimit dhe marrjen e masave për prishjen e tyre.

6 raste të papajtushmërisë me legjislacionin në fuqi duke lejuar ndërtime për të cilat INUV është kufizuar vetëm në mbajtjen e procesverbaleve të konstatimit, duke mos ndërmarrë asnjë veprim konkret për ndalimin dhe prishjen e ndërtimeve.

3 raste të papajtushmërisë me legjislacionin në fuqi duke lejuar ndërtime procedurat e të cilave INUV nuk i ka shoqëruar me vendim për gjobë.

2 raste të papajtushmërisë me legjislacionin në fuqi për të cilat INUV edhe pse ka marrë vendimet për prishjen e objekteve nuk i ka ekzekutuar, dhe për më tepër nuk i ka shoqëruar me penalitetet përkatëse.

16 raste të shkeljeve në fushën e ndërtimit për të cilat nuk janë marrë masat dhe nuk është kërkuar arkëtimi i gjobave në vlerën prej 4,800 mijë lekë, si dhe nuk janë ndjekur procedurat përkatëse penalizuese, për objektet ndërtimore dosjet e të cilave paraqisnin me parregullsi në dokumentacionin e lejeve të ndërtimit.

Mbështetur sa më sipër, KLSH ka kryer kallëzim penal Nr. 305/16 dt. 11.09.2014, **për Kryetarin e Komunës Golem Kavajë A.A. dhe ish-Kryeinspektorin e INUV Komuna Golem, Kavajë E.L.** të cilët në mos përmbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke i përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse